

**Shoqeria  
“ALFA SERVICES” Shpk  
Tirane**

**RAPORT I EKSPERTIT  
KONTABEL TË AUTORIZUAR**

**Për rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise.**

**Eksperti kontabel i autorizuar:  
Theodhoraq GJOSHA**

# RAPORT

## I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

( Mbi rritjen e Kapitalit Themeltar )

Une, i quajturi Theodharaq Gjoshë, Ekspert kontabel i Autorizuar i caktuar nga ortakut i vetem i shoqërisë dhe i miratuar me vendimin Nr 3343/3 datë 02.10.2003 për verifikimin dhe vertetimin e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë “ALFA SEVICES” sh.p.k. , paraqes raportin tim si më poshtë:

Shoqëria “ALFA SEVICES.” sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr 3343 datë 01.04.1994. Themelues të shoqërisë janë Lucia Maria Bertino dhe Fatos Çuçi . Kurse me vendimin 3343/1 datë 17.07.2003 Fatos Çuçi është pronar i vetem i shoqërisë pasi ka blerë kuotat e ortakut tjetër. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 7638 datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Që nga koha e krijimit shoqëria ka realizuar fitime, rezerva të tjera si dhe ka detyrime kundër ortakut që pasqyrohen në Pasiv të Bilancit në Grupin A Kapitalët e Veta si dhe, në Grupin B Detyrimet në postet e mëposhteme:

d) Rezervat	
- Rezerva të tjera	1,100,000 leke
e) Fitime të mbartura	7,877,413 leke
f) Fitime të ushtrimit 2002	6,004,555 leke
h) Ortakë	<u>9,932,998 leke</u>
<b>Totali</b>	<b>24,914,966 leke</b>

Shoqëria sipas vendimit nr.01 datë 05.09.2003 ka marrë në analizë miratimin e llogarive vjetore të vitit 2002 dhe ka vendosur si më poshtë:

Fitimi ushtrimor i vitit 2002 per shumen 6,004,555 leke , qe paraqiten ne bliancin e shoqerise , te kalojne ne masen 100% ne rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise ne favor te ortakut te vetem z. Fatos Çuçi.

Fitimet e mbartura para vitit 2002, ne shumen 7,877,413 leke, te kalojne ne rritjen e kapitalit themeltar.

Rezervat e tjera , ne shumen 1,100,000 leke, te kalojne ne rritjen e kapitalit themeltar.

Detyrimet ndaj Ortakut ,ne shumen 9,932,998 leke, te kalojne ne rritjen e kapitalit te shoqerise.

Per sa me siper Kapitali Themeltar i shoqerise, mbi bazen e vendimit nr.1 date 05.09.2003 te ortakut te vetem , pas shteses do te jete:

- Kapitali themeltar ekzistues	100,000 leke
- Nga Fitimi i ushtrimit	6,004,555 leke
- Nga Fitimet e shoqerise para vitit 2002	7,877,413 leke
- Nga Rezervat e tjera	1,100,000 leke
- Nga detyrimet ndaj ortakut te vetem	<u>9,932,998 leke</u>
- <b>Kapitali themeltar pas shtesave</b>	<b>25,014,966 leke</b>

Per kryerjen e misionit te ngarkuar une jam mbeshtetur ne bilancin e shoqerise deri ne fund te vitit 2002, ne dokumentat ligjore te shoqerise dhe ne vendimin e ortakut te vetem per miratimin e llogarive vjetore dhe shtesen e Kapitalit Themeltar.

Si perfundim, une vleresoj dhe vertetoj se kapitali themeltar i shoqerise “ALFA SEVICES” shpk nga 100,000 leke shtohet edhe me 24,914,966 leke dhe behet 25,014,966 leke ne favor te ortakut te vetem Z. Fatos Çuçi.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Theodharaq Gjoshja

